



Destinacion urban në rrugë e sipër

A e keni ditur se mesatarisht, gjatë një viti, rreth 200,000 turistë vizitojnë Prishtinën? Si arrijnë ata këtu dhe përse, përvojat të cilat i kërkojnë dhe çfarë u ofron atyre qyteti janë të gjitha pyetje që Komuna e Prishtinës, kryeqyteti i Kosovës, i konsideron si prioritet kryesor në kuadër të përpjekjeve të veta proaktive për ta shndërruar Prishtinën në një destinacion urban tërheqës, të përshtatshëm për turizëm gjatë të gjithë vitit. Qyteti ka karakter dhe ofron shumë shërbime e produkte për turistët.

“Kemi një rritje të numrit të vizitorëve prej 30% çdo vit. Komuna e Prishtinës synon ta shfrytëzojë momentumin për të facilituar edhe më mirë këtë fluks të turistëve, duke krijuar eksperiencë më të mira, produkte më të mira dhe të sigurohemi që turistët rikthehen. Duam ta promovojmë Prishtinën si e meriton”, thotë Yll Rugova, Drejtor për Rini dhe Kulturë pranë Komunës së Prishtinës.

Kështu, në mars 2018 Komuna e Prisht-

inës dhe projekti Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat (PPSE) nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi për të zhvilluar strategjinë e turizmit të Prishtinës. Strategjia përfshin edhe krijimin e një modeli efikas për menaxhimin e monumenteve të kulturës, zhvillimin e produkteve të reja turistike, restaurimin e trashëgimisë kulturore dhe trajnimin e guidave. Përveç kësaj, do të hapen edhe dy muze të rinj për të promovuar artin bashkëkohor të Kosovës: muzeu “Ibrahim Kodra” dhe Muzeu i Artit Bashkëkohor dhe Modern.

Fushëveprimi i bashkimit ndërmjet Komunës së Prishtinës dhe PPSE-së i kontribuon praktikave të qëndrueshme të turizmit. Këto ndikojnë në intensifikimin e promovimit të qytetit si destinacion, rritjen e numrit të turistëve dhe vizitorëve, të kohëzgjatjes së qëndrimit të tyre në Prishtinë dhe sa shpenzojnë. Kjo, nga ana e vet, i kontribuon direkt rritjes së turizmit dhe ekonomisë lokale në Kosovë pasi krijon vende të reja pune, rrit të ardhurat dhe mirëqenien në tërësi.

Muzeu Ibrahim Kodra

■ Koleksioni prej rreth 100 veprash nga Ibrahim Kodra do të prezantohen në muzeun më të ri që po hapet në Prishtinë, dedikuar këtij piktori të famshëm, i cili i ka prezantuar pikturat e tij për herë të parë në Kosovë në vitin 1967.

Vendosja në hartë e një destinacioni

■ Akterë të turizmit nga sektori privat dhe ai publik u takuan në një punëtori për analizim të destinacionit që u fasilitua nga PPSE për të gjeneruar kohezion të mendimeve se si Prishtina të vendoset në hartë si një destinacion turistik.

Destinacion i ri i preferuar për udhëtim: Prishtina, Kosovë

■ Shikojeni këtu videon nga Top Channel, Shqipëri <https://bit.ly/2vbGeqL>.

INFORMATA KRYESORE NGA PUNA JONË

Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat Faza II: nëntor 2017 - nëntor 2021

■ Qeveria zvicerane është e përkrahur ta përkrahë Kosovën që të arrijë rritje të qëndrueshme ekonomike dhe mirëqenie për të gjithë” tha Jean-Hubert Lebet, Ambasadori i Zvicrës në Kosovë gjatë ceremonisë së lansimit të fazës II të projektit Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat. Në këtë fazë, PPSE do të mbështesë rritjen ekonomike të Kosovës përmes krijimit të punësimit dhe nxitjes së konkurrueshmërisë së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, me investime prej më shumë se 7 milionë franga zvicerane. Videon që përmbledh rezultatet e Fazës I mund ta shikoni këtu <https://bit.ly/2Ol6VCg>.

Informata për Kosovën si destinacion turistik arrijnë në tregun aziatik



■ Kosova është ndryshe nga sa kam pritur. Por është një vend i bukur, me natyrë të bukur dhe shumë histori. Kosova është shumë mirë dhe e qetë” thotë Lauren Kim, gazetare për udhëtime për Newspim.com në Korenë e Jugut. Ajo thotë se ia vlen ta vizitosh Kosovën. Lauren ishte një nga gazetarët koreano-jugorë që udhëtuan për Kosovë në muajin maj të këtij viti për ta eksploruar vendin si destinacion. Përvoja intensive në Kosovë e gazetarëve koreano-jugorë përfshiu vizitë në zip-line në Pejë, në objekte fetare dhe historike në Prishtinë, Pejë, Gjakovë dhe Prizren, peisazhet natyrore dhe kullat tradicionale në Junik. Grupi shijoi ushqimet vendore dhe madje mori pjesë në përgatitjen e flisë! Ja një video <https://bit.ly/2JZLa7J>

Vizita katër-ditore e gazetarëve koreano-jugorë u organizua nga Fibula, mundësuar nga Ambasada e Republikës së Kosovës në Japoni, në bashkëpunim me Turkish Airlines dhe u mbështet nga PPSE.

Më herët gjatë këtij viti, një tjetër grup prej 55 operatorësh turistikë kryesisht nga vende aziatike e vizitoi Kosovën gjatë një udhëtimi familjarizues në kuadër të punëtorisë tetë-ditore ballkanike organizuar nga “Travel Shop Turkey”. Vizita në Kosovë u organizua nga operatori vendor “Veneta Travel”.

Qëllimi i këtyre udhëtimeve familjarizuese dhe të shtypit është që Kosova të promovohet në botë si destinacion turistik tërheqës.



Partneritete të reja që i japin shtysë suksesit

■ Në gjashtë muajt e parë të vitit 2018, PPSE nënshkroi disa marrëveshje të reja me partnerë lokalë për të përkrahur aktivitetet që variojnë nga prezantimi i prodhimit me fidanë të specializuar, tek prodhimi i farave të kungullit, certifikimi organik, kultivimi i bimëve mjekësore aromatike (BMA), deri tek prezantimi i inputeve organike për prodhimin e vajrave esenciale. Të gjitha këto marrëveshje partneriteti synojnë të sjellin inovacion, të avancojnë proceset dhe të rrisin mundësitë për punësim. Agrobora do të hapë një serë të specializuar për prodhim fidanësh

prej 2,000m², që të risë prodhimtarinë dhe të plotësojë nevojat e përpunuesve përmes bashkëpunimit me 800 fermerë. Peppermint International do të hapë pikën e parë për prodhim të fidanëve, gjysëm-përpunim dhe përpunim të BMA-ve në veri të Kosovës. Produktet Natyrore të Kosovës do të hapë linjën e parë për prodhimin e farave të kungullit në Kosovë duke përdorur teknologji të avancuar. 99 LULE do të kontrakttojë 10 gra fermere dhe do të rrisë sipërfaqen e tokës për të kultivuar katër kultura të reja të BMA. Shoqata ORGANIKA do t'i mbështesë kompanitë



që merren me BMA dhe produkte pyjore jodrusore që të kenë qasje në tregje të reja dhe të rrisin cilësinë e produkteve. Na përcillni për më shumë aktivitetet!

Të rinjtë fitojnë shkathtësi për industrinë e turizmit

■ Pasi diplomoi me sukses nga trajnimi për kamarierë që u organizua nga Tourism Organization Gračanica (TOG), Teodora Gjokiq tani ka më shumë se një opsion për të ardhmen e saj profesionale. Pas përfundimit të pjesëve teorike dhe praktike të trajnimit, Teodora thotë “Tani ka më shumë mundësi për mua. Mund të punoj si kamarieri me orar të pjesshëm, ose të hap biznesin tim dhe njohuritë t’i shfrytëzoj për të trajnuar punëtorët e mi”. Teodora është një nga rreth dyzetë të rinj nga Gračanica që kanë fituar shkathtësi të reja, që u ndihmojnë të gjejnë punë në industrinë e mikpritjes, kryesisht si kamarierë, ose që të jenë më të aftë në punën e tyre. Boban Petroviq nga TOG, që e organizoi këtë trajnim me mbështetje nga PPSE, thekson se përveç shkathtësive që të rinjtë fituan, ky trajnim u ndihmon hoteleve dhe restoranteve në këtë zonë të përmirësojnë cilësinë e shërbimit dhe kështu, të tërheqin më shumë tur-



istë. Teodora sheh dhe përfitime të tjera nga trajnimi. “Në fakt, shkathtësitë që mësuam janë të dobishme në çdo punë ku ka komunikim me njerëz”. Gjithashtu, Teodora tani mund të japë këshilla të shkëlqyera se cila verë shkon me ushqimin e porositur, gjë që është shumë me rëndësi. Shikojeni videon <https://bit.ly/2Ol954M>

Oferta e Kosovës arrin në tregje ndërkombëtare

■ Panairët specifikë për sektorë janë mundësi e rëndësishme dhe kanal marketingu për bizneset e Kosovës që të ekspozojnë dhe të promovojnë produktet, shërbimet dhe vendin si destinacion, por edhe për t’u mundësuar kompanive që të jenë në hap me zhvillimet botërore. Këtë vit, PPSE ka përkrahur kompanitë nga Kosova që të marrin pjesë në disa panairë ndërkombëtare të rëndësishme. Në shkurt, katër përpunues dhe eksportues të produkteve pyjore jodrusore organike, Agroproduct, Hit-Flores, Eurofruti dhe Fungo LLC ekspozuan në panairin BIOFACH në Gjermani, më i madhi në botë për ushqime organike. Pjesëmarrja e tyre u koordinua përmes shoqatës ORGANIKA. “Panairi BIOFACH në Gjermani ishte më i suksesshmi ku Agroproduct ka ekspozuar produktet e veta organike deri tani. Përkrahja nga PPSE ishte kryesore” tha Halit

Avdiaj, pronar. Në mars, Outdoor Kosovo, Altavia Travel, Eurokoha, Albtour dhe Kosova Holidays ekspozuan ofertën turistike të Kosovës në panairin më të madh botëror të udhëtimit ITB Berlin. Këtë vit, PPSE hyri në partneritet me Shoqatën e Përpunuesve të Drurit të Kosovës dhe programin e USAID-it EMPOWER Private Sector për të mbështetur dhe promovuar pjesëmarrjen e shtatë përpunuesve të drurit nga Kosova – Elnor, Shehu, Binni, Greenhouse, Koba, Graniti dhe Lesna – në panairin Swissbau që mbahet në Zvicër çdo dy vjet. Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë ishte partnere për panairë ndërkombëtare dhe në angazhimin me pjesëmarrës se si ata të shfrytëzojnë më mirë mundësitë që paraqiten në këto panairë për të bërë biznes, për të ekspozuar ofertën, për rrjetëzim dhe kultivim të imazhit të vendit.

A E KENI DITUR SE?

A

Rollercoaster me kablo, shtigjet në pemë, fluturimi me balon të lidhur dhe akomodimet alternative janë disa nga produktet e reja turistike që mund të zhvillohen në Kosovë, duke ia rritur kështu vlerën vendit si destinacion. Rekomandimet për rreth 25 produkte të reja turistike janë përfshirë në një raport nga MDP Consulting and Engineering, kompani me qendër në Francë, që u angazhua nga PPSE në kuadër të aktiviteteve për mbështetje e zhvillimit të turizmit në Kosovë. Këto rekomandime përfshijnë produkte për turizmin malor, kulturor, urban dhe të aventurës, që mund ta transformojnë ofertën turistike të Kosovës. Raportin e gjeni këtu <https://bit.ly/2M285Fm>

B

Zhvilloni biznesin përmes produkteve të reja dhe atyre të përmirësuar! Programi “Coaching for Growth” nga CEED Kosova është dizajnuar për drejtorë ekzekutivë dhe menaxherë të lartë nga kompani të përpunimit të ushqimit dhe konditorisë në Kosovë që të arrijnë vizionin e tyre për biznes. Sesionet e organizuara deri tani përmes programit janë krijuar për t’i pajisur kompanitë me modelet më të fundit të zhvillimit dhe përmirësimit të produkteve për të ndihmuar në rritjen në përgjithësi të kapaciteteve të kompanisë. Lexoni më shumë ë programin <https://bit.ly/2OkqyKN>

C

Njihuni me Ekspertët Seniorë të Zvicrës. Profesionistët tashmë në pension pjesë e Korpusit të Ekspertëve Seniorë (SEC) japin në mënyrë vullnetare njohuritë dhe përvojat e tyre për biznese të vogla dhe të mesme që kanë nevojë për konsulencë të tilla, por që nuk mund të përballojnë shpenzimet për konsulencë. Qëllimi i shërbimeve të SEC nga ekspertë vullnetarë të dalë në pension është rritja e konkurrueshmërisë së këtyre NMV-ve, përmirësimi i nivelit të shkathtësive të stafit të tyre, mbështetja për zhvillim të qëndrueshëm dhe gjenerimi i vendeve të reja të punës. Ja një artikull për punën e tyre <https://bit.ly/2niJuND> dhe për më shumë informata praktike mund të lexoni këtu broshurën <https://bit.ly/2OgbOf2>

D

Ananas Impex: nga 4 deri 24 tonë specia të përpunuar brenda 24 orëve. Nga 70 deri në 120 fermerë në rrjet. Pothuajse dyfishim i sipërfaqes së tokës së mbjellë. Rreth 12 vende të reja pune. Produkte të reja, të tjerat së shpejti. Zvicra një destinacion i ri i eksportit. Extra Fruit Filling: shitje të rritura me 500%, më shumë se 60 fermerë të rinj në rrjetin e bashkëpunëtorëve dhe më shumë se 15 vende të reja pune më orar të plotë të krijuara. Këta dy shembuj përmbledhin rezultatet deri tani nga partnerët e PPSE gjatë Fazës I përmes Fondit të Mundësive, që tregojnë se përkrahja në momentin e duhur është me rëndësi kyçe për bizneset.

Në shkurt, katër përpunues dhe eksportues të produkteve pyjore jodrusore organike, Agroproduct, Hit-Flores, Eurofruti dhe Fungo LLC ekspozuan në panairin BIOFACH në Gjermani



MODELI PËR NDRYSHIM



E ardhmja e bujqësisë së kontraktuar në Kosovë

■ Si mund të adresohen përnjëherë këto shqetësime të fermerit, prodhuesit të fidanëve dhe qendrës grumbulluese? Këtu hyn në lojë “bujqësia e kontraktuar”. Me pak fjalë, bujqësi e kontraktuar është procesi kur fermeri rrit perime për një blerës në bazë të marrëveshjes së arritur paraprakisht – që është Kontrata.

Një shembull se si PPSE promovon bujqësinë e kontraktuar në Kosovë, si një nga aktivitetet e veta kryesore. Kompania që merret me përpunimin e perimeve nënshkruan kontratë me Agro Celinën për sasi të caktuara dhe për cilësinë e caktuar të varieteteve hibride. Agro Celina krijon rrjetin e fermerëve që janë në gjendje dhe të gatshëm të prodhojnë kulturën e caktuar. Më pas, Agro Celina lidh prodhuesin e fidanëve të specializuar me fermerët. Këta

të fundit i blejnë fidanët nga ky prodhues në vend se t'i kultivojnë vetë nga e para sipas metodave tradicionale. Agro Celina grumbullon prodhimin dhe ia dërgon përpunuesit.

Të mirat e bujqësisë së kontraktuar janë të shumta. Fermerët arrijnë të kenë qasje tek prodhuesit e specializuar të fidanëve, të cilët i furnizojnë fermerët me fidanë dhe u japin teknikat që sigurojnë cilësinë e prodhimeve. Nga ana tjetër, prodhuesit e specializuar të fidanëve marrin vendime të mirëinformuara se cilat varietete të farave duhet të prodhojnë, duke siguruar kështu edhe tregun për to. Fermerët arrijnë të kenë qasje tek blerës më të mëdhenj vendorë dhe të huaj përmes qendrave të grumbullimit, që kanë nënshkruar kontrata me ata blerës. Qendra grumbulluese siguron furnizim

të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm me perime për blerësit e vet. Dhe, fermerët bëhen më të pavarur.

“Në kontekstin tonë aktual, bujqësia e kontraktuar është inovacion”, thotë Fehim Rexhepi. “Mbështetja nga Swisscontact përmes projektit Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat ka qenë katalizatori për të nisur ndryshimin. Ndryshimi nuk është nënshkrimi i kontratës. Ndryshimi i vërtetë është se ne kemi sfiduar mentalitetin tradicional dhe po i japim jetë një mënyrë të re të punës për fermerët. Kështu do të arrijmë efekte afatgjata”.

Falë këtij aktiviteti, fermerët shohin në praktikë se si planifikimi është me shumë rëndësi për të ardhmen. Ai jo vetëm redukton kostot, por ndihmon edhe me eliminimin e pasigurive dhe siguron jetë më të mirë për familjet dhe për komunitetin.

Lexoni këtu artikullin e plotë <https://bit.ly/2OOEc92>.

Rr. Sylejman Vokshi Nr.42 |10000 Prishtinë, Kosovo
Tel: +383(0)38220403
email: ppseinfo@swisscontact.org
website: www.ppse-kosovo.org and
www.swisscontact.org/kosovo
www.facebook.com/ppse.kosovo

Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat

Projekti Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim implementohet nga Swisscontact dhe Instituti Riinvest.